



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:264398

Datë: 19.06.2024

Numri i dokumentit: 05833944

KPPP.nr. 2041/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit NLB Banka Sh.A., me numër të biznesit 70053484 dhe seli në Prishtinë, rr. "Ukshin Hoti", nr. 124, kundër debitorëve; 1. "FR Stublla " O.P., me numër të biznesit 71160904 dhe seli në Viti, fshati ..., me pronar F.R., të cilin e përfaqëson Edison Simani, avokat nga Vitia; 2. V.R.N. me numër personal ... dhe adresë në Viti, fshati ...; dhe 3. F.R. me numër personal ... dhe adresë në Viti, fshati ..., duke vendosur sipas prapësimit të debitorit "FR Stublla " O.P., të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 695/2023, të lejuar me datë 08.11.2023 nga Përmbartuesi Privat Sheremet Livoreka me seli në Ferizaj, me datë 19.06.2024, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit "FR Stublla " O.P., i ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 695/2023, i lejuar me datë 08.11.2023 nga Përmbartuesi Privat Sheremet Livoreka.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr. 695/2023 i lejuar me datë 08.11.2023 nga Përmbartuesi Privat Sheremet Livoreka, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit NLB Banka Sh.A., me datë 08.11.2023, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 695/2023 kundër debitorëve "FR Stublla " O.P., V.R.N. dhe F.R., ashtu që janë detyruar të njëjtë, që mbi bazën e dokumentit përmbartimor Marrëveshjes mbi pengun Nr. K0221/1007, e datës 11.11.2021, e regjistruar në regjistrin e

pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20211112-160, si dhe Kontratës mbi Hipotekën LRP.nr. 7548/2021, e datës 09.11.2021, e regjistruar sipas Aktvendimit mbi regjistrimin e hipotekës Nr. 171, të datës 10.11.2021, për sigurimin e kërkesave nga Kontrata për kredi biznesi Nr. K0221/1007, t'ia paguajnë kreditorit borxhin në vlerë prej EUR 111,958.16 (me shkronja: njëqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë euro e gjashtëmbëdhjetë cent), me kamatë vjetore prej 9.50 % dhe kamatë vonesë ditore 0.08 %, duke llogaritur nga data 03.11.2023 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori "FR Stublla " O.P., përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetim se kreditori nuk ka pasur mirëkuptim ndaj debitorit dhe në mënyrë të parakohshme ka paraqitur propozimin për përmbarim sepse për shkak se i është ndaluar ushtrimi i aktivitetit të tij biznesor, i është vështirësuar edhe përmbushja e obligimeve ndaj kreditorit. Ka shtuar se është vonuar 100 ditë për pagesën e shumës së kredisë në shumë prej 9113.76 €, kurse për periudhat e mëhershme ka qenë i rregullt, duke premtuar se pasi që përfundojë karantina do të vazhdojë që të paguajë këstet e kredisë sipas marrëveshjes mes tyre. Tutje, ka theksuar se kërkesa për pagesën e kamatës prej 9.50 % dhe kamatëvonesës ditore prej 0.08 % është shumë e lartë, duke qenë se pa fajin e tij është ndaluar ushtrimi i veprimtarisë me të cilën merret. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të shfuqizohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetim se ka për qëllim zvarritjen e procedurës, pasi nuk është bazuar në dispozitat e nenit 71 të LPP-së, në të cilat në mënyrë taksative janë të cekura shkaqet për të cilat mund të ushtrohet prapësimi, e duke i shkaktuar dëm si rezultat i pamundësisë së realizimit të kërkesës së tij. Duke qenë se prapësimi nuk është mbështetur në prova, sipas nenit 69, par. 4 të LPP-së, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të vërtetohet.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22, pika 1.7 përcaktohet se *“kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit”*, ndërsa, me nenin 5, paragrafi 2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore përcaktohet se dokument përbarues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*. Në anën tjetër, me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Gjykata duke vlerësuar Marrëveshjen mbi pengun Nr. K0221/1007 e datës 11.11.2021, si dhe Kontratën mbi hipotekën LRP.nr. 7548/2021, e datës 09.11.2021, gjeti se të njëjtat janë hartuar në formën e paraparë me ligj dhe janë regjistruar në regjistrat publik, fakt ky që vërtetohet nga Konfirmimi mbi regjistrimit e pengut me R-20211112-160, respektivisht Aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës Nr. 171, të datës 10.11.2021, e po ashtu i janë bashkangjitur propozimit për përbarim në kopje të vërtetuar, dhe si të tilla përbëjnë bazë juridike për caktimin e përbarimit ngase i kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 22, pika 1.7 dhe 1.7a, lidhur me nenin 27 të LPP-së, për të qenë dokumentet të përbarueshme dhe njëkohësisht të përshtatshme për përbarim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit të ngritura në prapësim por gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrit përbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 73, paragrafi 1 dhe 3 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2041/23, datë 19.06.2024

Numri i lëndës: 2023:264398
Datë: 19.06.2024
Numri i dokumentit: 05833944

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.